



## Ftesë për ofertim

**Titulli i ofertës: “Furnizim me rafte metalike me mekanizëm të mbylljes me çelës”**

**Data e hapjes për ofertim: 08/05/2023**

**Data e mbylljes për ofertim: 19/05/2023**

Agjencioni për financim në Kosovë - AFK fton të gjitha kompanitë shërbyese të interesuara të paraqesin ofertat e tyre për tenderin e hapur “Furnizim me rafte metalike me mekanizëm të mbylljes me çelës”

### **Specifikime Teknike:**

Përmasat e rafteve (gjerësi x thellësi x lartësi) : 80cm x 60cm x 125cm

Raftet metalike të jenë prodhime cilësore me material prej hekuri, rezistent ndaj zjarrit si dhe të kenë mekanizëm të mbylljes me çelës, e preferueshme ngjyra e hirit

### **Kushtet e përgjithshme të ofertimit :**

Oferta duhet të përmbaj informatat si në vijim:

- Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit dhe Çertifikata e numrit Fiskal.
- Oferta financiare (çmimet duhet të jenë të specifikuar me TVSH)
- Vlefshmëria e ofertës, së paku një muaj nga data e dorëzimit.

### **Kushtet dhe rregullat e tenderit:**

Të gjitha ofertat origjinale të dërgohen të mbyllura në zarf me mbishkrimin “**Furnizim me rafte metalike me mekanizëm të mbylljes me çelës**” në adresën e zyrës qendrore të AFK-së në Pejë: Rruga “Lidhja e Prizrenit “Nr.1, kodi postar 30 000.

Për më shumë informata ju lutem na shkruani në [info@afkonline.org](mailto:info@afkonline.org).

*AFK mban të drejtën për anulimin ose ndryshimin e këtij tenderi në çdo kohë*

**Afati i fundit i pranimit të ofertave 19 /05/2023 ora 16:00.**